



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 125, Datë 19.06.2024

MBI

**DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË  
KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “SMART WATT” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, 7, 9, pika 5, dhe nenit 10, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.06.2024, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1210/3 prot., datë 14.06.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Smart Watt” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1210 prot., datë 23.05.2024, ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e kësaj shoqërie. Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1210/1 prot., datë 24.05.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.
- Duke qenë se akti i kalimit të kuotave është nënshkruar përpara se të merrej autorizimi përkatës i ERE-s për këtë transferim, në ERE është depozituar deklarata e përbashkët e dy shoqërive ortake, të cilat nën përgjegjësinë e tyre dhe me vullnet të lirë e të plotë, deklarojnë se në rast të mosmarrjes së miratimit nga ERE për transferimin e kuotave, ky transferim do të jetë i pavlefshëm dhe ato do të kalojnë në gjendjen fillestare, para se të kryhej ky transferim.
- Shoqëria “Smart Watt” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e

të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.

- Shoqëria “Smart Watt” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k.
2. Ortaku që kontrollon interesat e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k. bëhet “EXO Partners” sh.p.k.
3. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Smart Watt” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**